



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE**  
**BALLKANIKE**



**PROGRAMI I LËNDËS**  
**Gjuhë e Huaj C-4**

**Ngarkesa:** 4 kredite; 40 orë mësimore, 40 seminare  
**Viti / Semestri :** Viti II, semestri II  
**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme  
**Programi i studimit:** Bachelor – Gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk  
**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

**Objektivat e përgjithshme lëndore:** Studenti duhet të ketë njohuri themelore në gjuhën turke. Lënda gjuhë turke si gjuhë e dytë zhvillohet në dy module të vendosura në semestrin e parë dhe semestrin e dytë. Studentët do të punojnë me metodën e nivelit të avancuar, në nivelin B1- B2 të metodës së përzgjedhur për mësim. Do dinë të përdorin aftësitë e të lexuarit kritik në gjuhën e huaj si leximi për të marrë kuptimin, për të nxjerrë konkluzione. Do përdorin strategji komunikimi.

**Objektivat specifike lëndore:**

- 1.Shkrimi i prezantimeve, organizim i mësimi në gjuhën turke.
- 2.Puna me fjalor të avancuar duke përdorur hamendësimin, nxjerrjen e kuptimit nga konteksti, njohjen e parashtesave dhe prapashtesave.
- 3.Zgjerimin e fjalorit duke përdorur përkufizimin, përdorimin e fjalëve në fjali.

**Rezultatet e pritshme:**

- 1.Njohë dhe analizojë konceptet themelore të letërsisë turke, duke përvetësuar nocione kryesore teorike dhe historike.
- 2.Identifikojë dhe interpretojë pjesë të ndryshme të ligjëratës dhe stileve gjuhësore, si dhe të bëjë nën-kategorizimin e tyre sipas kriterëve stilistike dhe funksionale.
- 3.Zbatojë strukturat gjuhësore të mësuara në kontekste të ndryshme, si në analizën letrare, ashtu edhe në ushtrime praktike të përkthimit dhe komunikimit.
- 4.Zhvillojë kompetencat gjuhësore përmes leximit, diskutimit dhe interpretimit të teksteve letrare, duke ndërtuar një qasje të pavarur dhe analitike ndaj veprave të përzgjedhura.